**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

# RAPORT I DISKUTIMIT PUBLIK PËR "PROPOZIM PLANIN KOMUNAL PËR RI-INTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS 2023-2025

Diskutimi publik është mbajtur më 05.06.2023

## HYRJE

Në takim morën pjesë 18 qytetarë sipas listës së pjesëmarrësve në konsultimin publik. Mbledhjen e hapi Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim Liman Zeqiri ku prezentoj **Draft Planin Komunal për Ri-integrimine Qëndrueshëm të personave të Riatëdhesuar për Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.**

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Strategjinë për Mingrim 2021 - 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019).

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Bllokun 0, Ri pranimi dhe Ri integrimi tashmë janë përmbushur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Ri integrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Strategjia e Ri integrimit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integrimit është obligative të zbatohet në tëre territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit te Veprimit te Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2022 - 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues, kanë hartuar Planin Komunal për ri – integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Podujevës.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, datë 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRIH si institucion përgjegjës për ri integrim në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Podujevës përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, ne këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Podujevës.

**Shkurtesat**

| | |
|---|---|
| ANP | Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës |
| APRK | Agjensioni i Punësimit i Republikës së Kosovës |
| AZHBR | Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DRPRIH Huajve | Departamenti për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të |

| | |
|---|---|
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| EPPRM | Ekipi për Parandalim dhe Reagim për Mosbraktisje |
| KA | Komisioni për Ankesa |
| KASH | Korniza Afatmesme e Shpenzimeve |
| KKR | Komisioni Komunal për Ri integrim |
| MATP | Masat Aktive të Tregut të Punës |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MASHTI | Ministria e Arsimit, Shkencës,Teknologjisë dhe Inovacionit |
| MBPZHR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| MPJD | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës |
| MFPT | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| MKK | Ministria për Komunitete dhe Kthim |
| MMPHI | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim Asocimit |
| PR | Person i Riatdhesuar |
| PIR | Plani Individual i Ri integrimit |
| PII | Plani Individual i Integrimit |
| QAP | Qendrat e Aftësimit Profesional |
| QPS | Qendrat për Pune Sociale |
| SMR | Sistemi për Menaxhimin e Rasteve |
| ZKKK | Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim |
| ZP | Zyrat e Punësimit |
| ZGJC | Zyra e Gjendjes Civile |

**Punëtori pune** – Veprimi i komunave për Ri-integrim dhe diasporë – MARDI / CARITASI ZVICRAN

* Më 12.10.2022 – Punëtori me Grupet Punuese në Bogë për Hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve
* Me OJQ-të Ndërkombëtare MARDI/ CARITASI ZVICRAN
* MB – Departamenti për Ri-integrim të të riatdhesuarve dhe Integrimin e të Huajve – DRPRIH
* ZKKK – Komunale (Zyret Komunale për Komunitete dhe Kthim, Komisioni Komunal për Ri-integrim).
* Drejtoritë Komunale, Zyret e Punësimit, QPS (Qendra për Punë Sociale), Zyra e Gjendjes Civile ZGJC, Qendra e Aftësimit Profesional QAP.
* MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal)
* Ministritë tjera MASHT-i, MBPZHR, MPJD, MKK, MMPHI, MSH, MFPT (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve), MSA-ja (Marrëveshja e Stabilizim Asocimit)
* Më 12.10.2022 - 13 dhe 14.10.2023 – Takim pune Bogë – Pejë
* Më 29.11.2022 deri 30.11.202, 01.12.2022 – 02.12.2022 Punëtori pune Bogë – Pejë
* Më 29.03.2023 – 30.03.2023 – 31.03.2023 – Punëtori pune Prevallë – Prizren
* Më 17.05.2023 – 18.05.2023 – 19.05.2023 Bogë – Pejë Punëtori Pune
* Punëtori ZKKK-ja Komiteti Komunal Veprues në Komunën e Podujevës dhe bashkëpunimi dhe koordinimi me Drejtoritë Komunale si DKA-ja, DSHMS, Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore ZP, QPS dhe OJQ-të vendore dhe OJQ-të Ndërkombëtare OSBE-ja
* Takim pune për Hartimin e Draft Planit Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.
* ZKKK-ja më 07.03.2023 – Takim pune me OSBE-në dhe Komitetin Veprues Komunal.
* Më 28.04.2023 – Takim pune me Komitetin Veprues Komunal dhe Drejtoritë Komunale dhe QPS dhe Zyrën e Punësimit.
* Diskutim: pikë e rendit të ditës në Komitetin për Politikë e Financa më 12.05.2023
* Diskutim në Asamblenë Komunale, Kuvendi Komunal më 15.05.2023
* Diskutim me Komitetin për Komunitete më 31.05.2023

Përgatitje për Diskutim Publik më 05.06.2023

* Ku propozimet, sugjerimet apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për

Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ku mund të dërgohen edhe në e-mailin: liman.zeqiri@rks-gov.net të cilat pastaj përcillen në ZKKK brenda periudhës së diskutimit prej datës 22.05.2023 deri më 20.06.2023.

**Trajnim:**

* Veprimi i Komunave për Ri-integrim dhe diasporë
* Trajnimi për Implementimin e Udhëzuesit për Qasjen e të Huajve në Aftësim Profesional dhe Punësim
* Temat
1. Vlerësimi i nevojave të zyrtarëve
Qëllimet e trajnimit
* E drejta për punësim dhe qasja në tregun e punës
* Akterët kryesor përgjegjës për Integrimin Ekonomik të të Huajve
* Rregullat e përgjithshme për Integrimin në tregun e punës
* Vetëpunësimi
* Diskriminimi dhe diversiteti

**- Punësimi -**

* I huaji (personi) pasi ta fitojë statusin, shtetësinë e regjistrohet si person i riatdhesuar/ të huaj si punëkërkues ku informohen ata për të drejtat e tyre dhe mundësitë e mbështetjes në MATP (Masat Aktive të Tregut të Punës)
* Profilizimi dhe këshillimi i punëkërkuesve të riatdhesuar apo të të huajve; për profesionin që kanë për punësim, që kanë të drejtë të konkurojnë me të drejta të barabarta për punësim që i plotësojnë kushtet.

* Vetëpunësimi i të riatdhesuarve apo të të huajve përmes financimit të planeve të biznesit.

* Ku informohen këta persona për mundësitë dhe kushtet e përfitimit nga kjo skemë, prej ZKKK-së, ZP, QAP

* Kur thirrja të jetë e hapur për aplikim, ne iu ndihmojmë në kompletimin e dosjes për aplikim.

* Aftësimi profesional i personave të riatdhesuar dhe të huajve në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

**Prezentimi i :**

**Draft:** Plani Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar për Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025

* Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Migrim 2021-2025, rregulloren (QRK) nr 22/2022 për personat e riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve Rregulloren (QRK) nr. 09/2019.

* Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2023-2025

* Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe përfaqësuesit e Organizatave Vendore e Ndërkombëtare që veprojnë në Komitetin Komunal Veprues:
Kanë hartuar Planin Komunal për ri-integrim të qëndrueshëm dhe integrimin e të huajve për Komunën e Podujevës.

* Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, saktëson kornizën kohore për realizimin e aktiviteteve në koordinim me institucionet qëndrore dhe lokale MPB / Departamenti për Ri-integrimin e personave të riatdhesuar, për Integrimin e të Huajve DRPRIH / MPB – ZKKK, Drejtoritë përkatëse komunale, DKA-ja, DSHMS, DBF, Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, Qendra për Punë Sociale (QPS), ZP (Zyra e Punësimit), OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, me fokus për Ri-integrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë, QAP (Qendra e Aftësimit Profesional), ZGJC (Zyra e Gjendjes Civile) etj.

* ZKKK-ja prezentoi Draft Planin Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar për Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025

* Ku edhe u vlerësua lart puna dhe aktivitetit institucional i Komunës tonë Podujevës.

Për angazhimin e këtij procesi rol të rëndësishëm luajnë edhe OJQ-të Ndërkombëtare:

* UNDP – Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar, Ura 2, Awo Nurnbeerg
* IOM – Organizata Ndërkombëtare për Migrim, WOMEN FUR WOMEN (Gratë për Gratë)
* CARITAS-i ZVICRAN "TERE ZOM" (Terre des Homs) Fondacioni Zvicran
* GIZ-i Gjerman, DIAKUNIE (Qendra për Aftësim Profesional etj).

Raportin e përgatiti

SHZKKK - Liman Zeqiri

14.07.2023

Podujevë

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

**Procesverbal**
**nga**
**Konsultimi Publik me qytetar**

Tema: Propozim drafti i Planit Komunal për Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025

Takimi u mbajt në sallën e mbledhjes së kuvendit, ndërtesa e re e Komunës me datë 05.06.2023 dhe filloi në orën 10:00.
Në takim morën pjesë 18 qytetarë sipas listës së pjesëmarrësve në konsultimin publik. Mbledhjen e hapi **Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim Liman Zeqiri** ku e paraqiti **Prezentimin e Draft Planit Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar për Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025**

* Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Migrim 2021-2025, rregulloren (QRK) nr 22/2022 për personat e riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve Rregulloren (QRK) nr. 09/2019.

* Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2023-2025

* Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe përfaqësuesit e Organizatave Vendore e Ndërkombëtare që veprojnë në Komitetin Komunal Veprues:
Kanë hartuar Planin Komunal për ri-integrim të qëndrueshëm dhe integrimin e të huajve për Komunën e Podujevës.

* Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, saktëson kornizën kohore për realizimin e aktiviteteve në koordinim me institucionet qëndrore dhe lokale MPB / Departamenti për Ri-integrimin e personave të riatdhesuar, për Integrimin e të Huajve DRPRIH / MPB – ZKKK, Drejtoritë përkatëse komunale, DKA-ja, DSHMS, DBF, Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, Qendra për Punë Sociale (QPS), ZP (Zyra e Punësimit), OJQ-të vendore dhe

ndërkombëtare, me fokus për Ri-integrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë, QAP (Qendra e Aftësimit Profesional), ZGJC (Zyra e Gjendjes Civile) etj.

* ZKKK-ja prezentoi Draft Planin Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar për Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025

* Ku edhe u vlerësua lart puna dhe aktivitetit institucional i Komunës tonë Podujevës.

**Zyrtari për Integrim Evropian Ylber Salihu**, Zyra Komunale për Integrim Evropian është themeluar në kuadër të çdo komune krahas rregullores Nr.08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian, dhe veprojnë nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.
Misioni i Zyrës për Integrim Evropian është që në bashkëpunim me instancat përkatëse lokale dhe qendrore, të mbështesë Komunën në arritjen e Standardeve Evropiane dhe përmbushjen e obligimeve të dala nga dokumentet strategjike nacionale për Integrim Evropian si dhe të koordinoj të gjitha çështjet lokale të procesit të Integrimin Evropian, përmes respektimit të praktikave dhe rregullave të përcaktuara nga Bashkimi Evropian (BE).

- Zyra për Integrim Evropian bashkëpunon direkt me Minstrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL – Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Ministrinë e Punëve të Brendshme MPB – Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve DRPRIH, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale MPMS dhe të gjitha Drejtoritë komunale me të gjithë sektorët, me Institutin e Kosovës për Administratë Publike IKAP, Policinë, Entin e Punësimit, Qendrën për Punë Sociale QPS, Zyra e Pensioneve, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF, Kryqin e Kuq, Gjykatën, Qendrën e Regjistrimit Civil, po ashtu bashkëpunon me organizata të huaja: Ura 2, Awo Nurnberg, Caritas, Diakonie, IOM, OSBE, UNDP, GIZ Dimak, D&D Business Support Center, UNHCR, Balcan Sunflowers, Women for Women, Terres des Hommes etj, si dhe OJQ të ndryshme.

**Xhafer Ademi** bëri pyetje se kush e paguan çështjen e banimit / strehimit.

**Zyrtari për Integrim Evropian** ia sqaroi se për çështjen e banimit apo strehimit pagesën e bën Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve DRPRIH. Ne kemi obligim si komunë që bashkërisht me koordinatorin rajonal ta gjejmë vendin e banimit ku obligimet i merr Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve DRPRIH.

05.06.2023

Podujevë

Kryesuesi i mbledhjes

SHZKKK – Liman Zeqiri

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**Lista e pjesëmarrësve prezent në konsultimin publik për** ***Propozim Plani Komunal për Ri Integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 – 2025, e mbajtur më 05.06.2023, në sallën e Kuvendit të Komunës.***

| Nr. | Emri Mbiemri | Cilësia e pjesëmarrjes | Nr. tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ylber Salihu | ZKIE | | |
| 2 | Maljeta Rama | | | |
| 3 | Filloreta Çitaku | | | |
| 4 | Mirvete Merova | | | |
| 5 | MIMOZË RESTELICA | DPZHE | | |
| 6 | Xhevrie Begiri | ZKKK | | |
| 7 | Blerta Ajvazi | ZHPI | | |
| 8 | LIRIDONA ÇPAHMAN | | | |
| 9 | Verona Dibrani | | | |
| 10 | Selver RAMA | Anëtar i Kom. për Kom. | | |
| 11 | Enver RAMA | Anëtar KSB. | | |
| 12 | Xhafer Ademi | Kryesues Kom. për Kom. | | |
| 13 | Fitim Sejdiu | OJQ | | |
| 14 | Shkurte Sejdiu | anëtare e Kom. për Kom. | | |
| 15 | Liman Zejnei | SHZKKK- | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 16 | Ahmet Ahmeti | NDNJ | [signature] |
| 17 | Emine Tahiri | Zyra Biznesi | [signature] |
| 18 | Genc Gashi | Qytetar | [signature] |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |
| 36 | | | |
| 37 | | | |
| 38 | | | |
| 39 | | | |
| 40 | | | |